



Prishtinë / Priština
Nr./Br. 2482-2017

Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 106.1, 106.3 dhe 106.4 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe nenin 26 të Ligjit nr. 03/L-072 të për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 07.12.2017, nxjerrë këtë:

VENDIM

Për Certifikimin e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale 2017 për Kryetar Komune në Podujevë

- I. Pas përfundimit të të gjitha procedurave në Vendvotime dhe në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve si dhe kur të gjitha vërejtjet e dala që u përkasin votimit dhe numërimit janë vendosur nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) dhe nga Gjykata Supreme, **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve Certifikon Rezultatet Përfundimtare të Zgjedhjeve për Kryetar Komune në Podujevë të raundit të dytë, të mbajtura me datën 19 nëntor 2017, si në vijim:**
- II. **Për Kryetar Komune në Podujevë është zgjedhur Agim Veliu, nga subjekti politik: Lidhja Demokratike e Kosovës - LDK, me 20,027 vota në përqindje prej 63,78% të votave.**
- III. Rezultatet e Zgjedhjeve si në pikën I i janë bashkangjitur këtij Vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij. Po ashtu këto rezultate janë përfundimtare dhe detyruese.
- IV. Obligohet Sekretariati i KQZ-së që t'i publikojë në formë tabelare rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve në pajtim me këtë vendim.
- V. Ky vendim, hyn në fuqi me 07.12.2017.


Prishtinë, 07.12.2017

Valdete Daka

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve



Podujevë/Podujevo



■	AGIM VELIU	63.8%
■	AJET POTERA	36.2%
Total:		100.0%

Podujevë/Podujevo				
Emri/ Ime	Mbiemri/ Prezime	Emri i Partisë / Naziv Partije	Votave/Glasova	Përqindja/ Procentat
AGIM	VELIU	47 LDK - LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS	20,027	63,78%
AJET	POTERA	10 LËVIZJA VETËVENDOSJE!	11,373	36,22%